

“REFLEKSET KRIJUESE TË SHQIPES MBI GJERMANISHTEN”Butrint **BALAJ**¹**PËRMBLEDHJE**

Shqipja është gjuhë i.e që u ka shkaktuar kokëdhembje gjuhëtarëve të ndryshëm nëpër botë. Përcaktimin si gjuhë i.e e dha gjuhëtari gjerman Franz Bopp-i. Lidhja e gjermanëve me shqipen ka qenë tepër interesante dhe më e hershme. Gjermanët filluan të interesoheshin, ta studionin shqipen e ta shpërfaqnin nëpër qarqet intelektuale, përpara se Bopp-i të vinte në përfundimet e veta. Kështu, nisur nga interesi dhe profecia e Leibniz-it, pastaj duke vazhduar me Friedrich M. Müller, Xylander-it e Thunmann-it, Hahn-it etj, të cilët dhanë një kontribut për ndriçimin e fakteve shumë të rëndësishme për lashtësinë e gjuhës shqipe. Duke vënë në konsideratë këto, kemi arritje revolucionare gjuhësore nga filozofi i gjuhës Petro Zheji, i cili është themeltar i gjuhësisë simbolike, këndvështrim krejtësisht i ri mbi gjuhësinë në përgjithësi e për etimologjinë në veçanti. Reflektet krijuese të shqipes mbi gjermanishten lidhen drejtpërdrejt me motivimet etimologjike të leksikut të gjermanishtes përmes shqipes. Pra krahas bashkëpërkimeve gjuhësore në mes shqipes dhe gjermanishtes, siç janë fjalët që ngjajnë, ose siç është sufiks “en” i infinitivit të gjermanishtes, punimi shtjellon edhe motivimet tejmorfemore të fjalëve, si: *ast, bein, bitte, bremse, brille, feige, hirn, hund, löschen, spalt, sputum, unter, vogel, zunder* etj. Motivimet tejmorfemore janë zbërthime analitike përmes morfemave embrionale që janë fjalë të përbëra nga një zanore ose një zanore dhe bashkëtingëllore (së bashku), të cilat janë baza e ndërtimit të koncepteve (fjalëve). Zbërthimi analitik bëhet në përputhje me parimet e “Teorisë së embriomorfemave”. Reflektet e plota krijuese të shqipes mbi gjermanishten do t’i paraqes në librin me titullin “Gjermanishtja flet shqip (motivime etimologjike përmes shqipes)”.

Fjalët kyçe: *Leibniz, Müller, Xylander, Thunmann, Hahn, Petro Zheji, gjuhësia simbolike, morfema embrionale, embriomorfema, bashkëpërkimet, sufiksi “en”, koncepti, fjala,, motivimi tejmorfemor, Teoria e embriomorfemave, Gjermanishtja flet shqip.*

HYRJE

Volteri ka thënë: *Unë nuk jam dakord me atë që thua, por do ta mbroj deri në vdekje të drejtën tënde që ta thuash.* Pa çka se ky punim nuk mund t’i thotë të gjitha, gjithsesi një përpjekje e mirë është një punë ca më e veshme se kur iniciativa për përpjekje mungon. Tema për gjuhën shqipe dhe njëkohësisht ndërthurja e saj me simbolin jo medoemos lidhet me aspektin e teorisë së komunikimit, por ajo shkon më tutje, si një diçka e re, si një stad për të cilën gjuhësia ia ka nevojën. Kjo është etimologjia dhe procesi i pashmangshëm motivues për të njohur fjalën, rrjedhimisht për të njohur gjuhën. Fjala gjatë krijimit dhe rrugëtimit të vet nëpër kohë përveçse ka një histori ajo ka edhe një vlerë funksionale për të cilën do të diskutojmë.

Në kreun e parë do të jepen informacione të përgjithshme që lidhen me natyrën e shqipes si gjuhë me refleksë krijuese, një vështrim të shkurtër mbi gjermanët e gjermanishten dhe lidhja me shqiptarët dhe shqipen, pastaj një sinops të veprës së JR Xylander-it etj. Kreu i dytë i rezervohet një trajtimi teorik të shkurtër të simbolit gjuhësor (morfemës embrionale, baza e ndërtimit të

¹ *studiues*

fjalës), metodës dhe parimet e teorisë e cila na mundëson t'i kuptojmë këto reflekse krijuese (përmes motivimit etimologjik). Në fund, në kreun III do të diskutojmë shkurtimisht mbi pikëtakimet e paskajores së dialektit të gegërishtes verilindore dhe të gjermanishtes standarde (hochdeutsch), si dhe në fund shembujt argumentues mbi reflektet krijuese të shqipes, të ndërkalura në leksemat e gjermanishtes (por jo vetëm). Lidhja mes shqipes dhe gjermanishtes dhe interesimi i mëhershëm e i vazhdueshëm i studiuesve gjermanë nuk është i rastësishëm. Shqipja si gjuhë i.e u ka shkaktuar jo me pahir kokëdhembje linguistëve anë e mbanë këtij planeti. Ajo është konsideruar sa e afërt aq edhe e largët, sa e re aq e vjetër. Kështu, nisur nga interesi dhe profecia e *Gottfried W. Leibniz*, pastaj duke vazhduar me *J. Thunmann-it*, *J.R. Xylander-it* e *Friedrich Max Müller*, *J.G fon Hahn-it* etj, të cilët dhanë një kontribut për ndriçimin e fakteve shumë të rëndësishme për lashtësinë e gjuhës shqipe, porse ata nuk i thanë të gjitha sa kishte shqipja. Por a ishte e nevojshme të shikohej shqipja më ndryshe nga ç'e kishin parë albanologët e huaj? Pse shqipja shpesh ka arritur të zgjidhë mistere gjuhësore e të tregojë forma zhvillimi brenda vetes krejt ndryshe nga gjuhët e tjera? Mendimi ndryshe do të thotë të shikohet se si shqipja u dha gjuhëve të tjera dhe se ka ardhur koha që munda dhe borxhi që ajo dha të shpaguehet, ky shpagim është veçse e vërteta për gjuhën, për të cilën përpiqemi të gjithë.

1. PËR SHQIPEN E GJERMANISHTEN

1.1 Gjuha Shqipe

Në mesin e shumë familjeve të trungut të gjuhëve i.e (= indoevropiane) gjendet edhe gjuha shqipe si një degë më vete autentike dhe e lashtë. Por sa kanë arritur të tjerët ta njohin si gjuhë të lashtë? Në përsiatjen kërkimore të shumë gjuhëtarëve e studiuesve gjejmë vepra të llojeve të ndryshme dhe të interpretimeve të ndryshme. Disa studiues shqipen e vendosin si gjuhë më të hershme (në krahasim me disa të tjera) e disa të tjerë më të vonshme. *Problemi i një lashtësie të tillë prek, natyrisht, edhe shumë probleme të tjerë, siç është ai i vendit që zinin paraardhësit e shqiptarëve në Evropë, trevat në të cilat qenë përhapur, nga shtegtuan, si dhe një varg çështjesh të tjera që lidhen me kulturën e lashtë, me mitet e ndryshme, me ndikimet reciproke të popujve mes tyre etj*². Por shpesh studiuesit e huaj kanë kundërthënë në pohimet e tyre dhe siç duket ata edhe pse e vendosin shqipen si gjuhë të lashtë, asaj i japin "epitetin" e një gjuhe të formuar krejt vonë...kur vjen puna për ta shpjeguar etimologjikisht, e trajtojnë si një gjuhë të re, e madje fort të re, sikur të harronin ç'kishin thënë më parë, duke shkelur kështu, mbi një të vërtetë që sot sa vjen e po bëhet më e dukshme³. Për lashtësinë e saj flasin edhe shumë gjuhëtarë të tjerë, por le ta citojmë studiuesit Cavalli Sforza-n dhe Alberto Piazza-n, të cilët pohojnë se: *...Ishim në gjendje për ta reformuar një Pemë të Re të gjuhëve. Në këtë pemë të re, rrënja e gjuhës shqipe veçohet nga ajo e gjuhëve të tjera, ajo duhet të ripozicionohet më saktë, sepse shkalla e gabimit të vendosjes së saj, është tashmë e rendit 71 përqind...*⁴.

Duhet pasur parasysh se gjuha shqipe edhe pse ka "mungesë të dokumentimit (deri vonë)", nuk do të thotë se asaj i humbet primati i një gjuhe të lashtë! Pse? Po, po të merret e mirëqenë kjo

² Petro Zheji, *Shqipja dhe Sanskritishtja (pjesa I)*, Tiranë, 2005, faqe 19.

³ Po aty, faqe 20.

⁴ Cavalli Sforza, Alberto Piazza, *Diffusion of Genes and Languages in Human Evolution (Difuzioni i Gjeneve dhe Gjuhëve përgjatë Evoluimit Njerëzor)*, Romë, 2006, faqe 259.

logjikë, atëherë pse latinishtja e gjashtë greqishtet etj. vdiqën edhe pse ato qenë të shkruara. Këtu del një problem tjetër që mbase gjuhëtarët e huaj nuk e kanë marrë përsipër ta shpjegojnë, kurse Petro Zheji pohon: *gjuha paraqet në vetvete një karakteristikë mjaft të çuditshme – është edhe e vjetër, edhe e re, ka aftësinë e fosileve për të ruajtur kujtimet e së kaluarës më të hershme, edhe aftësinë e një elementi që është në gjendje të pasqyrojë fenomenet e reja*⁵. Pikërisht këtu lidhet edhe thelbi i punimit, me këto “elemente fosile” që shqipja i ka të ndërkallura te konceptet e gjuhëve të tjera i.e. Elementi fosile gjendet në çdo leksemë dhe pikërisht ky punim lidhet me reflekset krijuese të shqipes mbi gjermanishten.

1.2 Gjermanët dhe gjermanishtja si dhe lidhja me shqiptarët e shqipen

Në rrjedhën historike nuk është rastësi se leksiku i disa gjuhëve i.e ngjason ose ka bashkëpërkime. Gjermanishtja sikundër edhe gjuhët e tjera të trungut i.e kanë bashkëpërkime në shumë aspekte. Gjermanishtja në veçanti ka një lidhje interesante leksiku me shqipen, sa për këtë të fundit, ajo (gjermanishtja) nuk është fare e panjohur. Shikuar edhe në të dhënat që sot ofrohen të formës antropologjike e historike, kuptojmë se përpos gjuhës edhe tregues të tjerë i bashkëngjitën dhe kjo nuk paraqet më rastësi, se pse gjermanët janë marrë me shqipen. *Edhe të dhënat antropologjike sot dëshmojnë se raca gjermanike dhe shqiptarët kanë një tregues qafalik të njëjtë. Si gjermanët dhe shqiptarët sot janë brakicefal në pjesën më të madhe të popullsisë. Brakicefal ka qenë popullsia e Evropës që nga Paleoliti dhe Mezoliti që tregon për një autoktoni të padiskutueshme të shqiptarëve dhe gjermanëve*⁶.

Edhe në aspektin gjuhësor përderisa fjalët ngjajnë, ato referojnë te një logjikë e përbashkët “koduese” dhe në këtë aspekt, duhet të jetë pikërisht një gjuhë që atë kod e dekodon, sikundër ndodh komunikimi në mes pajisjeve elektronike. Duke qëndruar edhe më tej në aspektin historik, dimë se është pohur se shumica e fiseve gjermanike janë ilire dhe në shumë raste jepen të dhëna interesante e mbreslënëse historike, përmendim këtu shkurtimisht edhe të dhënat për gotët. *Gotët janë myzët dhe kanë etnicitet të përbashkët me trakët, dakët dhe skythët. Nga ana tjetër sipas burimeve trakët, dakët, ilirët, skythët, trojanët janë të një etnie. Gjuha shqipe është e vetmja që shpjegon dhe përkthen dakishten e vjetër*⁷. Ky mendim duhet vlerësuar, sepse nuk është thjesht një mendim, por një gjë që edhe të tjerët më parë e kanë pikasur. Tani në këtë stad, ne do të shkojmë përtej “morfemës klasike”, që do të thotë se do ta motivojmë leksemën përtej saj si formë e ngurtësuar (nëse mund ta quajmë), duke e dërguar atë në qendrën embrionale, aty ku edhe referojnë konceptet ose fjalët.

1.2.1 Një sinops: Xylander-i, “Gjuha e albanëve ose shqipëtarëve”⁸

Ashtu siç e kemi trajtuar edhe më sipër, vlen të theksohet se me shqipen dhe leksikun e saj janë marrë shumë albanologë. Gjermanët, siç duket shihnin diçka te shqipja që i tërhiqte shumë. Nisur nga G.W Leibniz, i cili në fillim nuk qe dakord me mendimet se shqipja ishte gjuhë autentike dhe shumë e rëndësishme, por më vonë ai jep një pohim monumental për shqipen: *Në qoftë se duam ta dimë historinë para Krishtit dhe shkencat e asaj kohe, duhet t'i drejtohem gjuhës shqipe*, thënie lapidare, që sot na nxit për t'i gjetur ato të vërteta. Duke u përpjekur ta ndërtojmë

⁵ Petro Zheji, *Shqipja dhe Sanskritishtja (pjesa I)*, Tiranë, 2005, faqe 20-21.

⁶ Elena Kocaqi, *Roli Pellazgo-Ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane*, Tiranë, 2009, faqe 174.

⁷ Po aty, faqe 177.

⁸ JR. Xylander, *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren* (përkthimi nga origjinali: Albert Gjoka dhe Frida Vokopola).

mendimin mbi bazën e albanologëve të huaj, këtu s'duhet harruar fillimisht edhe J. Thunmann-in, por veçanërisht edhe Xylander-in që sigurisht bashkë edhe me të tjerët pas tyre u munduan ta ndriçonin pak nga energjia që ka shqipja dhe nga rëndësia si gjuhë i.e. Duke qëndruar pak këtu, citojmë Xylander-in: *Një përcaktim i bazuar i prejardhjes së këtij populli ose i gjuhës së tij nuk do të kontribuonte vetëm për të ndriçuar historinë e paqartë në tërësi të atyre vendeve, por ndoshta edhe disa prej historive tona më të vjetra në përgjithësi, gjithashtu do të kontribuonte edhe në ndërtimin e gjerë të shkencës sonë të re të gjuhësisë dhe për këtë, interesi i gjithanshëm historik dhe shkencor lidhet me zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe veçanërisht me njohjen e gjuhës shqipe, ku koha e sotme këtij interesi i ka shtuar edhe nevojën e praktikimit të drejtpërdrejtë të saj.*⁹ Xylander-i e kishte të qartë se shqipja paraqet një brumë shumë të rëndësishëm i.e. Edhe pse ai kryekëput në fillim u mor me Gramatikën e Da Lecce-s e të Leak-ut, dhe për ne paraqet rëndësi kreu ku ai merret me fjalët (*përmbledhje fjalësh shqip – gjermanisht dhe anasjelltas*) dhe krejt në fund me *kërkime mbi origjinën e shqipes dhe afërsinë fisionore të saj*¹⁰. Xylander-i me veprën e vet i njohu më nga afër qarqet intelektuale evropiane me shqipen. Ai u bazua në punën e studiuesve të tjerë, nisur nga Leibniz-i, Thunmann-i, Adelung-u, J.S Vater etj.

Në të vërtetë, ky punim nuk do t'i kushtohet shumë aspektit historik të shqipes apo të gjermanishtes. Punimi ka në thelb shpërfaqjen e refleksive krijuese dhe ndonjë pikëtakim specifik në mes shqipes dhe gjermanishtes. Me bashkëpërkimet veçanërisht janë marrë shumë studiues, duke u përpjekur kështu t'i gjenin vendin shqipes duke e dhënë të prejardhur nga kjo e ajo gjuhë. Ky raport ndërron kur në bazë vihet studimi i fjalës përmes formës së saj embrionale dhe jo konceptuale, pikërisht për këtë në vijim do të kemi shembuj për ta argumentuar dhe shpjeguar më mirë se si shqipja arrin të kuptohet e ndërkallur në konceptet (fjalët) e gjermanishtes. Pra prejardhjen e një gjuhe nuk mund ta përcaktojmë pa e ditur se nga se është ndërtuar ajo gjuhë, veçanërisht se si gjuha i shpjegon fjalët e veta që i ka ngjizur në leksikun e vet. Ky nocion shkon përtej sinkronisë dhe diakronisë, sepse në thelb ka fjalën dhe synimin për ta gjetur se si është krijuar ajo, dhe krejt kjo nëpërmjet një teorie që i përfshin të gjitha parimet, ligjet e rregullat.

2. ELEMENTI GJUHËSOR EMBRIONAL

2.1 Simboli dhe morfema embrionale

Në vazhden e konceptimit të gjuhës si një fenomen shoqëror, e pashmangshme del të jetë simboli i përfaqësimit të gjuhës së folur në të shkruar. Simboli ose morfema embrionale në vetvete nuk paraqet thjesht një transformim tingullor në një paraqitje grafike, por para se gjithash, simboli në vetvete i ka të gjitha dhe baza për të është bashkëtingëllorja. Simboli si aspekt grafik ka marrë përmasa të studimit matematik, teknik dhe në shkencat moderne shpesh shihet si një frekuencë tingullore e shndërruar në një vijëzim logjik përmes grafikës (problemi se si janë krijuar grafemat). Pa marrë parasysh se cilat janë teoritë e reja që studiojnë simbolin (pse ekziston simboli), rëndësia është se ai lidhet direkt me të konceptuarit e gjuhës dhe ndërtimit të saj, me fjalën, me vetë morfemën. Një rol të rëndësishëm në kuptimin e idesë së simbolizmit (nëse mund

⁹ J. Ritter von Xylander, *Gjuha e albanëve ose shqipëtarëve (Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren)*, Frankfurt am Main, 1835 (përkthyer nga origjinali Albert Gjoka dhe Frida Vokopola).

¹⁰ Po aty.

ta quajmë) si karakter i vet gjuhës të ngjizur me kohë, luan edhe “Algoritmi simbolik” i studiuesit dhe filozofit të gjuhës, Petro Zhejit. Sipas P.Zhejit, gjuha funksionon sipas një parimi logjik dhe se çdo fjalë ka karakter mitik e si e tillë ajo mund të kuptohet vetëm po të ndahet nga vetë koncepti i krijuar (zbërthimi ose motivimi etimologjik). “Algoritmi simbolik” është një artikullim logjik i mendimit mistik të stërllashtë, për të cilin Petro Zheji punoi një jetë të tërë. Qëndrimin filozofik, P.Zheji e mbështet në disa aspekte të rëndësishme, si: gjendja e fragmentuar e mendimit mistik, mundësia e artikullimit logjik të mendimit mistik, mendimi mistik edhe qendra etj. “Algoritmi simbolik” përfshin shumë rrafshe të shkencës mbi të cilat mund të zbatohet dhe nga i cili mund të nxjerrim rezultate, si: mjekësia, fizika, filozofia, gjuha etj.¹¹ Por dy parimeve të këtij algoritmi i shtohen edhe një sërë të tjerash, si parimi embriomorfologjik, parimi ekonomik në ngjizjen e fjalës, parimi i funksionalitetit, parimet fonetike dhe në thelb pastaj kemi “Teorinë e embriomorfemave” (shih te seksioni i motivimit etimologjik) si tërësi.

Në anën tjetër, duke e ditur se gjuha përbëhet prej fjalëve, gjuhësia edhe pse e ka përkufizuar fjalën si kategori leksiko-gramatikore, ajo akoma nuk ka arritur të përcaktojë se *ç’është fjala si kategori gjuhësore?* Kështu, në vijim do të mundohemi të shpërfaqim ose të qartësojmë se pse ka munguar përkufizimi i thënë më sipër (fjala si kat. gjuhësore), thënë më shkoqur, do të hidhet poshtë aspekti arbitrar e konvencional mbi fjalët, dhe në vend të saj, do ta kuptojmë se fjala në fakt është bashkimi i atyre morfemave embrionale që funksionalisht rrinë të pavarura kur janë më vete dhe emërtojnë një realie ose dukuri kur ato bashkohen ose përngjiten (si koncept).

2.2 Teoria e morfemave embrionale dhe motivimi etimologjik

Morfema embrionale del të jetë forma themelore e fjalës. Në “Teorinë e embriomorfemave” gjuha shqipe del me rreth 366 embriomorfema (fjalë embrionale), që në gjuhë të tjera i.e i hasim shumë më pak. Këto fjalë të shkurta të përbëra nga bashkimi i një bashkëtingëlloreje dhe një zanoreje (forma progresive) dhe anasjelltas, bashkimi i një zanoreje e një bashkëtingëlloreje (forma regresive), përfshirë këtu edhe zanoret e vetme dhe të kombinuara ose diftongjet (p.sh. a, i, y, u, o; ai, ay etj.), japin elementet thelbësore në tabelën e embriomorfemave. Lidhja e këtyre embriomorfemave sipas një funksioni të caktuar jep konceptin. Koncepti i referohet fjalës e cila në vetvete përmban më shumë se dy embriomorfema, thënë më shkoqur, numri i bashkëtingëlloreve përcakton numrin e morfemave embrionale¹². Nuk duhet harruar të theksohet se embriomorfema përmban polisemi brenda vetes, pra ajo mund të ketë më shumë se një kuptim, çka i përgjigjet një logjike të thellë të një gjuhe të lashtë (shqipja), p.sh embriomorfema [re] del me disa kuptime: a) re=pamja, b) re=(i,e) re, c) re=”ti re nga shkalla” (folje e parregullt) etj. Pra brenda spektrit semantik të morfemës embrionale ekziston një spektër polisemie që i përgjigjet një logjike specifike. Numri i morfemave embrionale (embriomorfemave, simboleve) është relativisht i madh, për dallim nga gjermanishtja, e cila ka rreth 29 morfema embrionale.

¹¹ Shih: Petro Zheji, Roli Mesianik i Shqipes, Tiranë, 2015.

¹² Kur thuhet morfema embrionale, embriomorfema ose simbol kemi për bazë të njëjtën gjë.

Motivimi etimologjik lidhet kryekëput me ndarjen e një koncepti (fjale) në morfema embrionale (shih tabelat më poshtë). Ndarja dhe operimi me embriomorfema ose simbole nënkupton ndarje elementare (B+Z, Z+B, Z)¹³ sipas parimeve të caktuara të kësaj teorie¹⁴.

Le t'i radhisim disa nga parimet:

1. *Parimi i algoritmit simbolik (P. Zheji).*
2. *Konceptet referojnë tek e mbramja, pra te simboli (P. Zheji).*
3. *Parimi i funksionalitetit dhe i vetisë kryesore në emërtimin e realieve.*
4. *Fjala i takon gjuhës në të cilën motivohet.*
5. *Parimi ekonomik në ngjizjen e fjalës.*
6. *Parimi embriomorfologjik.*
7. *Parimi fonetik.*
8. *Parimi i kallëpit etimologjik.*
9. *Parimi melodik i fjalës.*
10. *Parimi alegorik.*

¹³ B=Bashkëtingëllore, Z=Zanore

¹⁴ Për këtë do t'ju flasë në një referat të veçantë Agron Dalipaj, po në këtë kuvend.

2.2.1 Tabelat e embriomorfemave, baza e reflekseve krijuese të fjalës

SHQ.	PROGRESIVE						
B/Z	A	E	Ë	I	O	U	Y
B	BA	BE	BË	BI	BO		
C	CA	CE		CI			
Ç	ÇA	ÇE	ÇË	ÇI	ÇO	ÇU	ÇY
D	DA	DE		DI	DO	DU	DY
DH	DHA	DHE		DHI	DHO		
F		FE		FI			FY
G	GA						
GJ	GJA	GJE	GJË	GJI	GJO	GJU	GJY
H	HA	HE	HË	HI	HO	HU	HY
J	JA	JE		JI	JO	JU	
K	KA	KE	KË	KI	KO	KU	KY
L	LA	LE	LË	LI	LO	LU	LY
LL					LLO		
M	MA	ME	MË	MI	MO	MU	
N	NA	NE	NË	NI		NU	NY
NJ	NJA	NJE	NJË	NJI	NJO		
P	PA	PE	PË	PI	PO		
Q	QA	QE	QË	QI	QO	QU	QY
R	RA	RE		RI	RO	RU	RY
RR	RRA	RRE		RRI	RRO	RRU	RRY
S	SA	SE	SË	SI	SO	SU	SY
SH	SHA	SHE		SHI	SHO	SHU	
T	TA	TE	TË	TI	TO	TU	TY
TH	THA	THE		THI	THO	THU	THY
V	VA	VE	VË	VI	VO	VU	VY
X	XA	XE	XË			XU	
XH	XHA	XHE	XHË	XHI			
Z	ZA	ZE	ZË	ZI	ZO	ZU	
ZH				ZHI			ZHY

GJER.	PROGRESIVE							
B/Z	A	Ä	E	I	O	Ö	U	Ü
B			BE			BÖ(E)		
C								
D	DA						DU	
F								
G			GE					
H								
J	JA		JE					
K								
L								
M								
N							NU	
P					PO			
Q								
R								
S					SO			
T								
V								
W					WO			
Z							ZU	

Në këtë tabelë e shohim qartë se si shqipja formon fjalët-grimca ose embriomorfemat që më pas shërbejnë për ngjizjen e konceptit (fjalës). Sigurisht në një koncept të motivuar veprojnë edhe rregullat të tjera (shih parimet te seksioni i mësipërm), por që në fund na dërgojnë në këtë qendër tabelare, që pak a shumë duket sikur tabela e Mendeljevit. Këtu kemi paraqitur formën

progresive tableare të morfemave embrionale të të dy gjuhëve, të shqipes dhe të gjermanishtes. Katrorat e zbrazët tregojnë se nuk ekziston ajo morfemë embrionale në atë gjuhë. Për embriomorfemat e shqipes, bazë është kryesisht dialekti i gegërishtes.

Në plan të parë duket qartë diferenca e embriomorfemave dhe avantazhin e padiskutueshëm të shqipes në raport me gjermanishten (shih sipër tabelat). Marrim një rast konkret për të anticipuar në lidhje me refleksat krijuese të shqipes mbi gjermanishten, p.sh. po ta marrim fjalën *die Bitte* (shq. lutje, me u lut), dhe po ta ndajmë në morfema embrionale (bashkëtingëllore+zanore/ zanore+bashkëtingëllore) do të na dalë: *BI'TTE* => *BI'(T)TE* => *BI'TE* => *TE'BI* => *TË'BI*, të bi(e), me ra, me u ul, sepse kur i lutesh dikujt, i ulesh atij; shqipja foljen *bi(e)* e ka folje supletive (folje që ndryshon formën në kohën e kryer të thjeshtë), por njëkohësisht edhe polisemike, sepse **bi**="ka (m)bi fara" (dialekti i gegërishtes); **bi**=bi(ja) e dikujt, bi(e)=me ra (dialekti i gegërishtes) etj.

Më tej, nëse marrim mundin dhe shikojmë tabelën e morfemave embrionale të gjermanishtes (sipër në të djathtë) shohim se mungon edhe embriomorfema [bi], por edhe [të/te], e para folje dhe e dyta pjesëz (në këtë rast). Këtu shqipja qartë jep se si është ngjizur fjala, pra ajo duke shpërngjitur konceptin e jep në përputhje me një funksion ose karakteristikë (pajtohet me parimin e funksionit ose të karakteristikës së realies). Nuk duhet harruar se edhe fjala *lutem* (folje e zgjedhimi II, mënyra dëftore, koha e tashme, forma joveprorë) me **anagramë** (lexim së prapthi) jep: *lutem* ⇔ *metul* => *me't'ul* => *me't(u)'ul*, rrjedhimisht, një kuptim më të saktë mund ta japim edhe më qartë kështu: *u(në)+me+të+ul(un)* => *u'me't'ul* => *me't'u'ul* => *me't'(u)ul* => *me't'ul* => *metul* ⇔ *lutem*. Pra shqipja po arrin ta zbërthejë (motivojë) fjalën e vet dhe atë të gjermanishtes, rrjedhimisht ajo posedon një informacion gjithëpërfshirës për këto dy koncepte, pavarësisht mënyrës së formimit.

Duke qëndruar edhe pak këtu, bëjmë një veprim të kundërt. Pra marrim fjalën e shqipes *lutem* (e zbërthyer me embriomorfema: *me+tu+ul*) dhe po ta kërkojmë sipër te tabela e embriomorfemave të gjermanishtes, nuk do të arrijmë ta kuptojmë, sepse asnjëra nga to (me; tu; ul) nuk kanë kuptimin dhe rrjedhimisht nuk e plotësojnë ngjizjen e konceptit (fjalës *lutem*). Në tabelë nuk është dhënë forma e embriomorfemave regresive (zanore+bashkëtingëllore), por gjithsesi jemi në dijeni për esencën e motivimit sipas logjikës embriomorfale. Ndodh kështu edhe me konceptet e tjera që kur hyjnë në procesin motivues, konvergjojnë në fund te tabela e embriomorfemave. Për më tepër rreth refleksive krijuese kemi marrë shembuj tipikë në kreun III, pika 3.2 ku janë afro 10 fjalë të thjeshta me të cilat shohim qartë aftësinë e refleksive krijuese të shqipes. Me një fjalë, i vërejmë qartë ato forma embrionale të fjalëve të ndërkallura te fjalët e gjermanishtes, por edhe te gjuhët e tjera i.e. Shqipja i ka ruajtur këto forma që janë të kudondodhura nëpër leksema të gjuhëve të ndryshme i.e dhe jo vetëm në gjermanishte.

3. NGA PIKËTAKIMET TE REFLEKSET KRIJUESE TË SHQIPES

3.1 Shqipja dhe gjermanishtja, një pikëtakim në infinitiv

Gjermanishtja, ashtu sikurse shqipja është pjesë e familjes së gjuhëve i.e, degë e grupit të gjuhëve gjermanike, përkatësisht degë e gjuhëve perëndimore. Gjermanishten e flasin një

popullsi rreth 120 milionë, pra ajo është gjuhë zyrtare në Gjermani, Zvicër e Austri. Ashtu siç e kemi thënë edhe në seksionet e mësipërme, gjermanishtja si gjuhë i.e ka të përbashkëta dhe dallon me gjuhët e tjera i.e. Në interesin tonë, do ta shohim se si qëndron raporti në mes shqipes dhe gjermanishtes kryesisht në leksik, dhe jo vetëm. Pra si ka shqipja aftësi reflektive krijuese mbi një gjuhë si gjermanishtja, pikëtakimet dallimet dhe refleksi krijues mbi leksikun e një gjuhe tjetër. Për këtë, mendoj se nuk mjafton shikimi i gjuhës në rrafshet e famshme sinkronike e diakronike, por në kuadër të zbërthimit etimologjik përmes një teorie të saktë.

Shqipja e gjermanishtja nuk është se kanë aq shumë pikëtakime në aspektin gramatikor, ose thënë më shkoqur në atë strukturë ndërtimi gramatikor e sintaksor, ato madje kanë dallime. Një pikëtakim edhe pse të trajtuar nga gramatikanë e gjuhëtarë, duket të jenë format e pashtjelluara të foljes, përkatësisht infinitivi ose paskajorja e dialektit të gegërishtes dhe të gjermanishtes standarde. Gjermanishtja ka tri forma të pashtjelluara të foljes, *infinitivin*, *participin I* dhe *participin II*¹⁵. Meqenëse ka pasur diskutime në lidhje me këtë, interesi ynë është vetëm përmendja e disa pikëtakimeve në mes infinitivit të thjeshtë të gjermanishtes dhe infinitivit të gegërishtes verilindore (në mënyrë specifike), të cilën e mendoj si një fosile të gjallë që shqipja e ka ruajtur brenda vetes, por që e ka më të lokalizuar në dialektin e gegërishtes verilindore. Gjithsesi, e dimë se forma e thjeshtë e infinitivit të gjermanishtes nuk ka një formë tipike ekuivalente me të shqipes standarde, por mund të themi se ajo gjendet e fshehur në dialektin e gegërishtes verilindore me sufiksin e njëjtë "en", që i shtohet një foljeje të kohës së tashme. Sigurisht se kjo kërkon një studim më të thellë dhe duke i prekur nga afër të folmet, por ato ndodhen pikërisht në të folmet e Kosovës, në nëndialektet e saj. Ndonëse qëllimi i këtij punimi nuk është trajtimi kryekëput me aspektin gramatikor e sintaksor, e shohim të udhës të japim një tabelë me disa krahasime përkatëse që mund t'i quajmë reflektive, ku foljet e shqipes me sufiksin "en" i kemi në të dy gjuhët me pak dallime. Shohim më poshtë tabelën me disa raste të marra sa për ilustrim (pasi punimi do ta trajtojë më tepër aspektin etimologjik reflektiv krijues të shqipes mbi gjermanishten):

Tabela e paskajores në dialektin e gegërishtes verilindore dhe gjermanishtes standarde (hohchdeutsch):

Shqipja	Gjermanishtja
Me ba(en)	Mach(en)
Me fol(en)	Sprech(en)
Me than(en)	Sag(en)
Me dredh(en)	Dreh(en)
Me lyp(en); me kërk(en)	Such(en)
Me dhez(en); me ndez	Zund(en)

¹⁵ Gramatika Duden.

Me lujt(en)	Spiel(en)
Me thy(en)	Brech(en)
Me gjet(en)	Find(en)
Me hap(en)	Öffn(en)
Me marr(en)	Nehm(en)
Me jap(en)	Geben(en)
Me mshel(en)	Schließ(en)

Siç edhe duket, dallimi thelbësor është se shqipja (dialekti i gegërishtes) në këtë rast e formon paskajoren përmes formës analitike: *me + folja në kohën e tashme (mënyra dëftore) + en*, ngjashëm me gjermanishten, porse kjo e ka në formën sintetike. Në fakt, sipas studiuesve shqipja e ka pasur një formë sintetike, por që e ka zhvilluar me kohë atë analitike. Ngjashmëria duket se nuk është e rastësishme; shikojmë një përafri "gjenetike" që ndan shqipja me gjermanishten edhe në këtë rrafsh, jo vetëm në leksik. Sigurisht se do të duhej një punim i tërë dhe një hulumtim terreni në lidhje me frekuencën e përdorimit të sufiksit "en" te paskajorja e gegërishtes verilindore, respektivisht në të folmet e Kosovës. Ajo edhe sot është e gjallë dhe e hasim në rajonin e Anamoravës, por jo vetëm, e hasim edhe në Rrafshin e Dukagjinit, por më të lokalizuar dhe me më pak përdorim.

3.2 Reflekset krijuese të shqipes mbi gjermanishten, motivime etimologjike

- ❖ **AST.** Do të thotë: **degë; degëzim** etj. Po të kemi parasysh "Pemën e familjes", vërejmë se dega është [shtim] pasi nga një çift del një familje. Siç duket gjermanishtja ka pjesën "me u shtu" brenda konceptit, pra: AST => A'ST => A'SHT => A'SHTë => A'SHTu, asht' shtu (dialekti i gegërishtes).
- ❖ **BEIN.** Do të thotë: **këmbë**. Këmbët janë ato që mbajnë gjënë (njeriun, kafshën) dhe pa të cilat ka vështirësi të lëvizjes. Pra gjermanishtja shtron këtë motivim: BEIN => BAJN (ei=>aj) => mBA'JN => mBA'GJN => mBA'GJëN, me mbajt gjanë (rënia e fonemës [b] ka ndodhur sikurse te rasti: mbi=bi /ka mbi fara = ka bi fara/). Gjithsesi foljen [mba] gjermanishtja nuk e ka të lirë si embrimorfemë.
- ❖ **BREMSE.** Do të thotë: **frenë; zekth** etj. Kur frenojmë ne e prejmë rrugën, ose përmes pre(mjes) e bëjmë ndalimin. Gjermanishtja shtron këtë motivim: BREMSE => BRE'M'SE => PRE'M'SE (**b:p**, bodrum : podrum) => PRE'M'ZE (**s:z**, gas : gaz) => PRE'M'e'Zë => Zë'M'e'PRE => e zë me të pre(me), zë me e ndalë (dialekti i gegërishtes).
- ❖ **BRILLE.** Do të thotë: **syze**. Syzet na përmirësojnë shikimin, pra na shërbejnë për t'i vërejtur gjërat më mirë, me një fjalë na e lind shikimin nga mungesa. Fjala motivohet kështu:

BRILLE => **BRILE** => **VRI'LE** => **VRE'LE** => **VRE'LE**, vre(mjen) lind, e lind shikimin, e lind atë që vërejmë; këmbimi **b:v** (sikurse: **barka=varka**); **vre(j)**=folje, **le**=folje (me lind, me le /dialekti i gegërishtes/).

- ❖ **FEIGE**. Do të thotë: **fik**. Kur fiku piqet, mund të vërejmë se ai fiket, sepse për sa është i papjekur, ai rri përpjetë. Gjermanishtja shtron këtë motivim: **FEIGE** => **FAIKE** (**g:k**, **e:a**, i lig : i **lik**, rreth : rrathë) => **FAIK** => **F(A)IK** => **FIK**. Më tej: **FIK** => **BIK** (**f:b**, këmbim i rregullt i buzoreve) => **BI'K** => **BI'Ka** => **Ka'Bie**¹⁶.
- ❖ **HIRN**. Do të thotë: **tru**. Truri luan rolin themelor në të menduarit e të vepruarit të njeriut (sidomos) dhe si funksion ka ruajtjen e informacionit e pastaj përpunimin e tij¹⁷. Gjermanishtja jep: **HIRN** => **H'IRN** => **K'IRN** (**h:k**, **haos : kaos**) => **K'IRuN** => **Q'IRuN** (**k:q**, ky : qy) => **Që'IRuN**, asht' që i run informacionet (dialekti i gegërishtes), dijet etj.
- ❖ **HUND**. Do të thotë: **qen**. Qeni karakterizohet me përdorimin e hundës për ta gjetur e kapur gjahun. Ai i ndien aromat lehtë dhe këtë njeriu e ka shfrytëzuar mirë. Pra: **HUND** => **HUND** => **KUND** (**h:k**, **haos : kaos**) => **K'U'NDë** => **Ka'U'NDi** => **U'Ka'NDi** => u ka ndi (ndi = ndijim me anë të ndarjes së aromave). Vetë fjala qen jep: **që+e+ndi** (që nuhat) => **që'e'ndi** => **që'e'n(d)i** => **që'e'ni** => **q'e'ni** => qeni.
- ❖ **LEBEN**. Do të thotë: **jetë; rrojtje**. Vetë e qenieve të gjalla është se ato luajnë, kurse nuk luajnë jo të gjallat. Gjermanishtja shtron këtë motivim etimologjik përmes embriomorfemave të shqipes: **LEBEN** => **LE'BEN** => **LUB'ËN** => **bën lu(mje)**, asht' i gjallë (dialekti i gegërishtes). E kundërta e të *gjallës* është e *vdekura* dhe në greqisht kemi fj. *nekros* (shih fj. *mort*¹⁸), që gjithashtu motivohet: **nek'ros** => **nek'los** (**r:l**, *arbitër=albitër*) => **nuk'los** (por edhe: **nuk'rro(n)**).
- ❖ **SPALT**. Do të thotë: **plasë; e çarë**. Kur një gjë ka plasje ajo edhe çahet, si rrjedhojë çarja shkakton zhbërje, e zhbërja bëhet edhe nga një e vra(me). Gjermanishtja shtron këtë motivim: **SPALT** => **PLAST** (me **metatezë**, sikurse: **velenxë=levenxë**) => **PLAS'T** => **T'PLASë** => të plasë, që plasë. Vetë fjala *plasë* duket se referon te fjala "*vras*", sepse plasja shkaktohet me "*vramjen*" e gjësë, rrjedhimisht: **plasë** => **ulasë** => **vrasë** => **vra'zë** (**p:v**, **l:r**, **s:z**, këmbime të rregullta fonemore) => **zë'vra** => **zë'b'ra** => **zë'bë'ra**, zë e bëj ra(mje).
- ❖ **SPUTUM**. Do të thotë: **këlbazë**. Këlbaza manifestohet me nxjerrjen e kësaj jarge e cila i bllokun rrugët e frymëmarrjes dhe me kalimin e ajrit nxit kollën, kështu nxjerrja e kësaj jarge bëhet me anë të pështymës. Megjithëse fjalën sputum e sjellin nga latinishtja, e motivojmë shkurtimisht kështu: **SPUTUM** => **PUSTUM** (**metatezë**, sikurse: **shpëtoj=pështoj**) => **PUSHTUM** => **PUSHTYM** => **BU'SHTY'M** => **BO'SHTY'Ma**, ban shty(mje) ma (tej, tutje), e

¹⁶ Agron Dalipaj, *Gjuha Kozmike II, Korçë, 2017, faqe 56.*

¹⁷ Po aty, faqe 70.

¹⁸ Po aty, faqe 117.

nxjerr. Edhe fjala *këlbazë* duket se referon te kjo përngjitje: *kelb asht' za => kelb'a'za => kelbaza, tutje: kelb => k'el'b => q'el'b => q'er'b (l:r, albitër : arbitër) => që'erë'bën, dhe një gjë e kalbur i vie era, bën erë.*

- ❖ **UNTER.** Do të thotë: **nën, poshtë** etj. Me këmbimin e rregullt fonemor **t:d** (gati: gadi), gjermanishtja shtron këtë motivim përmes shqipes: *UNTER => UNDER => O'NDER => O'NDËR => osht' ndër, osht' nën* (dialekti i geg.). Parafjalën *ndër* e gjejmë edhe si *nër/nën* me ç'rast kuptohet se kemi sinkopë (rënia e tingullit në mes) të fonemës [d], rrjedhimisht kemi: *NDËR => NDËN (r:n, vrer:vner) => NËN'D => NËN'T (d:t, shih sipër) => NËN'Të, nën'(a)të gjënë, poshtë gjësë. Ndërsa vetë fjala nën duhet të ketë ardhur nga një: rën => ran => ra'n(ë) => në'ra(nje), poshtë.*
- ❖ **VOGEL.** Do të thotë: **zog; shpend.** Edhe këtu shqipja jep prehje logjike për gjermanishten: *VOGËL => VO'GË'L => VO'GJË'L (g:gj, zgat : zgjat) => VO'GJË'LE => GJË'LE'VO => GJË E LINDUR NGA VEZA, GJO'VO'LE = VO'GJË'LE = VO'GË'L = VO'GEL = VOGEL. Ashtu sikurse fjala fole¹⁹, që me këmbimin e rregullt **f:v** (fshtirë : vështirë) jep: fole => vole => vo'le.*
- ❖ **ZANK.** Do të thotë: **zënkë, grindje, sherr.** Kuptimisht lidhet me fjalinë e shqipes, që ndërtohet kështu: *U'KA'ZAN => ZAN'U'KA => ZANUKA => ZANËK => ZANKA => ZANK.* Gjermanishtja nuk e posedon të lirë morfemën embrionale ose simbolin [zë/zu/zi/za], si folje, sikurse e ka shqipja (shih *zank*²⁰).
- ❖ **ZUNDER.** Do të thotë: **eshkë; çakmak; ndezëse.** Eshka, çakmaku e ndezësja kanë si emërues dukurinë e zjarrit dhe si funksion ndezjen e tij. Eshka e përçon zjarrin në formë të sigurt dhe ajo e ruan atë të ndez-ur, rrjedhimisht: *NDEZ+RU => NDEZ'RU => NDEZ'UR => NDEZUR => ZUNDER (metatezë, shih shembujt sipër). [shih edhe eshkë²¹].* Shohim se fjala *zunder* dhe *ndezur* kanë të njëjtat fonema, por i kanë të ndërruar vendet (metatezë), sikurse ndodh me fjalën [e ru di t] dhe [di t e ru], pra fjala *erudit*, që e vërejmë me pjesëmarrjen e bashkëtingëlloreve në këtë fjalë.

PËRFUNDIM

Kur u nis ky punim isha i vetëdijshëm për gjerësinë e kësaj teme. Kam grumbulluar një numër veprash që lidhen direkt me temën ose që më kanë ndihmuar rreth temës. Për shtjellimin e temës u mundova të tregohem i kujdesshëm, ku secilën pjesë të përmbajtes e trajtova me rëndësi të veçantë. Në disa raste kemi edhe digresione (tek-tuk) ashtu që punimi të shpërfaqet më i kuptueshëm e më i thjeshtë. Në kreun e parë u mora me pohimet e studiuesve për shqipen, duke trajtuar me kujdes atë se ç'kanë thënë të tjerët për gjuhën shqipe e duke vazhduar më tej me problemet që shfaqen në aspektin e huazimit dhe kërkesa për një qasje të re për këto problematika. Sot për sot, kemi shumë studime serioze në lëmejtë historisë, antropologjisë, etnografisë etj., mjafton të përmendim: Matheu Aref, Aristidh Kolen, Niko Stilon etj., të cilët dhanë një kontribut të rëndësishëm në fushat përkatëse si dhe në gjuhë. Kurse sa i përket

¹⁹ Po aty, faqe 55.

²⁰ Petro Zheji, Roli Mesianik i Shqipes, Tiranë, 2015, faqe 490, 747.

²¹ Agron Dalipaj, Gjuha Kozmike, Korçë, 2016, faqe 54.

etimologjisë kemi veprat voluminoze të shkencëtarit Petro Zheji, që i dha një dimension tjetër gjuhës dhe në veçanti fjalës e etimologjisë, duke vazhduar me Agron Dalipajn dhe nismën e tij për "Teorinë e embriomorfemave". Zbërthimin e fjalëve përmes morfemës embrionale ose simbolit duke u mbështetur në *Teorinë e embriomorfemave* e gjejmë në shembujt e motivimit etimologjik në kreun e tretë.

Vlen të theksohet se pasi i trajtova shembujt e motivimit etimologjik, dolën rezultate evidente ku tregonin se *parimi i funksionalitetit* mbizotëronte ndaj *karakterit konvencional* apo *arbitrar* të gjuhës (rrjedhimisht të fjalës), sidomos aty shqipja e përjashton se fjala mund të ketë karakter arbitrar a konvencional, sepse ajo arrin t'i zbërthejë fjalët e veta dhe fjalët e gjermanishtës, duke treguar se në vete ka një informacion gjithëpërfshirës dhe real në brumin e vet. Por të kuptosh të vërtetën ose realen është një gjë që kërkon kohë e përkushtim maksimal, sepse nuk ka dy të vërteta, ajo është vetëm një dhe pikërisht kësaj tentojmë t'i afrohem. Nga shembujt praktikë e kuptuam fare qartë një të vërtetë që strukej e s'e gjenim dot për aq kohë; pamë se gjuha është një matematikë e veçantë ose një botë kimike shumë interesante dhe tejet komplekse. Kështu, krejt në fund, kur flitet rreth së vërtetës dhe për të vërtetën, është e nevojshme të citojmë thënien e famshme të Shopenhaurit: *E gjithë e vërteta kalon nëpër tri faza. Së pari, ajo tallet. Së dyti, ajo kundërshtohet me dhunë dhe së treti, ajo pranohet si e vetë-provueshme.*

STUDIME MBËSHTETËSE

- [1] Aref Mathieu, *Shqipëria (Historia dhe gjuha) ose odisea e pabesueshme e një populli parahelen*, "Plejad", Tiranë, 2007.
- [2] Dalipaj Agron, *Gjuha Kozmike*, "Kotti", Korçë, 2015.
- [3] Dalipaj Agron, *Gjuha Kozmike II*, "Kotti", Korçë, 2017.
- [4] Duden, *Die Grammatik (Unentbehrlich für richtiges Deutsch)*, "Beltz Bad Langensalza", Berlin, 2016.
- [5] Dhrimo Ali, *Fjalor Gjermanisht-Shqip*, "Toena", Tiranë, 1998.
- [6] Imami Petrit, *Origjina e fjaleve të gjuhës shqipe*, "Buzuku", Prishtinë, 2011.
- [7] Katapano Xhuzepe, *Thoti fliste shqip*, "Botimet enciklopedike", Tiranë, 2007.
- [8] Kluge Friedrich, *Etymologisches Wörterbuch der deutschen Sprache*, "Vero Verlag GmbH & Co", Norderstedt, 2015.
- [9] Kocaqi Elena, *Roli Pellazgo-Illir në formimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane*, "Emal", Tiranë, 2009.
- [10] Konda Spiro, *Shqiptarët dhe problemi Pellazgjik*, "Uegen", Tiranë, 2011 (ribotim).
- [11] Krispi Xhuzepe, *Shqipja nëna e gjuhëve*, "Plejad", Tiranë, 2009.
- [12] Robins Robert H., *Historia e gjuhësisë*, "Dituria", Tiranë, 2007.

- [13] Sfroza Cavalli, Piazza Alberto, *Diffusion of Genes and Languages in Human Evolution*, Romë, 2006.
- [14] Thunmann Johann, *Historia dhe gjuha e shqiptarëve dhe vllhëve (pjesë nga libri "Studime mbi historinë e popujve të Europës Lindore", përkthyer nga origjinali: A.Gjoka & F.Vokopola)*, "Gent Grafik", Leipzig, 1774.
- [15] Xylander J. Ritter, *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren (përkthyer nga origjinali: A.Gjoka & F.Vokopola)*, "Turdiu", Frankfurt am Main, 1835.
- [16] Zheji Petro, *Shqipja dhe Sanskritishtja (Pjesa e parë)*, "Tertiumdatur", Tiranë, 2005 (ribotim).
- [17] Zheji Petro, *Shqipja dhe Sanskritishtja (Pjesa e dytë)*, "Tertiumdatur", Tiranë, 2006.
- [18] Zheji Petro, *Libri i Aforizmave*, "Mediaprint", Tiranë, 2012.
- [19] Zheji Petro, *Roli Mesianik i Shqipes*, "Uetpress", Tiranë, 2015.